

Prill, 2026

Pasqyrim rajonal: Ku qëndron rajoni në Grupkapitullin 1 të BE - Parimet Themelore?



Implementuar nga:



Mbështetur nga:



Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e autorëve.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi – IKD, Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes – CSDG dhe Qendrës për gazetari hulumtuese SCOOP Macedonia.

Kjo përmbajtje nuk pasqyron pikëpamjet e Fondit të Ballkanit Perëndimor – WBF.

Prill, 2026

Përmbajtja

1.	Qëllimi i pasqyrimit dhe mesazhet kryesore.....	7
2.	Qasja dhe Metodologjia	8
3.	Kuptimi i Grup Kapitujve 1 – specifikisht Kapitujt 23 & 24	9
4.	Pamja Rajonale: Ku qëndrojnë vendet sot	10
4.1.	Trendi rajonal: progres i ndryshëm me sfida të përbashkëta	11
4.2.	Pozicioni dhe roli i BE në ofrimin e një qasje të qartë të integritimeve	13
4.3.	Plani i Rritjes	15
5.	Përfundime kryesore nga punëtoritë	17
5.1.	Përfundimet nga punëtorja në Tiranë	17
5.2.	Përfundimet nga punëtorja në Prishtinë	18
5.3.	Përfundimet nga punëtorja në Shkup	19
6.	Specifikat e vendeve të rajonit (Overview)	20
6.1.	Shqipëria: Nga reforma në negociata	23
6.2.	Maqedonia e Veriut: Kornizë adekuate, progres i moderuar	24
6.3.	Kosova: Sfida e funksionimit institucional	25
6.4.	Kapitulli 23: Krahاسimi mes vendeve të rajonit	26
6.5.	Kapitulli 24: Krahاسimi mes vendeve të rajonit	27
7.	Roli i Shoqërisë Civile	28
8.	Rekomandimet.....	29

1. Qëllimi i pasqyrimit dhe mesazhet kryesore

Ky pasqyrim synon të ofrojë një përmbledhje të shkurtër, krahasuese dhe të përqendruar mbi gjendjen e vendeve të përzgjedhura të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Grup Kapitujve 1 – Parimet Themelore, me fokus të veçantë në Kapitujt 23 dhe 24, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformën në administratën publike. Nëpërmjet kësaj qasjeje, ky pasqyrim synon të identifikojë pozicionin aktual të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës në procesin e integritit evropian, të evidentojë sfidat e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet tyre, si dhe të nxjerrë në pah lidhjen ndërmjet reformave formale dhe rezultateve konkrete në praktikë.

Po ashtu, ky pasqyrim synon të sqarojë se progresi në kuadër të Grup Kapitujve 1 nuk matet vetëm me miratimin e legjislacionit apo me ndërtimin formal të kornizës institucionale, por mbi të gjitha me funksionimin efektiv të institucioneve, kapacitetin për zbatim, koordinimin ndërinstitutional dhe krijimin e rezultateve të qëndrueshme në sundimin e ligjit. Në këtë kuptim, dokumenti synon të ofrojë jo vetëm një përshkrim të gjendjes aktuale, por edhe një lexim rajonal të prirjeve kryesore që karakterizojnë procesin e integritit në këto fusha.

Njëkohësisht, pasqyrimi synon të sqarojë se progresi në kuadër të Grup Kapitujve 1 nuk matet vetëm me miratimin e legjislacionit apo me ndërtimin formal të kornizës institucionale, por mbi të gjitha me funksionimin efektiv të institucioneve, kapacitetin për zbatim, koordinimin ndërinstitutional dhe krijimin e rezultateve të qëndrueshme në sundimin e ligjit. Në këtë kuptim, ky pasqyrim synon të ofrojë jo vetëm një përshkrim të gjendjes aktuale, por edhe një lexim rajonal të prirjeve kryesore që karakterizojnë procesin e integritit në këto fusha.

2. Qasja dhe metodologjia

Ky dokument është hartuar mbi bazën e një qasjeje rajonale dhe krahasuese, e cila mundëson analizimin paralel të zhvillimeve në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë në kuadër të Grup Kapitujve 1 – Parimet Themelore. Analiza mbështetet kryesisht në raportet për vendin të Komisionit Evropian, si burimi bazë për vlerësimin e nivelit të përgatitjes, progresit dhe sfidave në fushat që mbulohen nga Grup Kapitulli 1, përfshirë sundimin e ligjit, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformën në administratën publike. Krahas këtyre raporteve, janë përdorur edhe dokumente të tjera relevante të institucioneve të Bashkimit Evropian, si dhe materialet e prezantuara dhe diskutimet e zhvilluara në kuadër të punëtorive rajonale të mbajtura në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

Metodologjia kombinon analizën cilësore të dokumenteve me qasjen krahasuese ndërmjet vendeve. Në aspektin përmbajtësor, fokusi është vendosur në identifikimin e prirjeve kryesore në Kapitullin 23, Kapitullin 24, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformën në administratën publike, duke vlerësuar jo vetëm ekzistencën e kornizës ligjore, por edhe nivelin e zbatimit, funksionalitetin institucional dhe rezultatet e arritura në praktikë. Në këtë kuadër, analiza është ndërtuar në mënyrë të tillë që të reflektojë si dallimet ndërmjet vendeve, ashtu edhe sfidat e përbashkëta rajonale.

Si pjesë e qasjes metodologjike, gjetjet nga punëtoritë rajonale janë përdorur për të plotësuar dhe kontekstualizuar analizën e bazuar në dokumente zyrtare. Këto punëtori kanë ofruar perspektiva shtesë mbi mënyrën se si kuptohen dhe zbatohen reformat në praktikë, duke nxjerrë në pah sfida që lidhen me llogaridhënien, koordinimin institucional, funksionimin e institucioneve dhe rolin e shoqërisë civile në procesin e integritetit. Në këtë mënyrë, pasqyrimi ndërthur analizën dokumentare me diskutimet tematike të zhvilluara në nivel rajonal, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të plotë dhe më të balancuar mbi gjendjen aktuale dhe prirjet kryesore në rajon.

3. Kuptimi i Grup Kapitujve 1 – specifikisht Kapitujt 23 & 24

Grup Kapitujt 1 – Parimet Themelore (*Fundamentals*) përbëjnë bërthamën e procesit të integritetit evropian dhe shkon përtej Kapitujve 23 dhe 24, duke përfshirë një vlerësim tërësor të funksionimit të shtetit. Përveç sundimit të ligjit që mbulon pavarësinë e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat themelore, sigurinë dhe migracionin ky grup kapitujsh përfshin edhe funksionimin e institucioneve demokratike, reformën në administratën publike, kriteret ekonomike, si dhe fusha si prokurimi publik, statistikën dhe kontrollin financiar. Në metodologjinë e zgjerimit, kapitujt 23 dhe 24 hapen të parët dhe mbyllen të fundit, pasi progresi në këto fusha përcakton kredibilitetin dhe ritmin e të gjithë procesit të anëtarësimit, duke reflektuar jo vetëm ekzistencën e kornizës ligjore, por mbi të gjitha kapacitetin real të shtetit për zbatim, koordinim dhe funksionim efektiv.

Në thelb të këtyre grup kapitujve qëndrojnë Kapitulli 23 dhe Kapitulli 24, të cilët adresojnë dimensionet kryesore të sundimit të ligjit.

➤ Kapitulli 23 përqendrohet në gjyqësorin dhe të drejtat themelore, si shtylla kryesore për ndërtimin e një shteti të së drejtës në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Për vendet aspirante, ky kapitull përfaqëson një mundësi për të forcuar një gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe efikas, si dhe për të garantuar respektimin e plotë të të drejtave themelore. Lufta kundër korrupsionit dhe ndërtimi i institucioneve të besueshme janë elemente kyçe për avancimin drejt BE-së. Përmes reformave të qëndrueshme dhe përkushtimit institucional, vendet aspirante mund të afrohen drejt një sistemi drejtësie që siguron barazi, transparencë dhe besim publik, në përputhje me “*acquis*” dhe Kartën e të Drejtave Themelore. Prandaj fokus kryesor ky kapitull ka:

- funksionimin dhe pavarësinë e gjyqësorit,
- luftën kundër korrupsionit,
- dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

➤ Kapitulli 24 mbulon Politikën e BE-së për vendet aspirante në forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e kufijve, migracionit dhe azilit, si dhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, përmes harmonizimit të legjislacionit dhe zbatimit efektiv të tij. Një administratë e integruar dhe institucione ligjzbatuese profesionale, të besueshme dhe efikase janë thelbësore për arritjen e këtyre standardeve. Përmes reformave dhe bashkëpunimit rajonal, vendet e rajonit mund të afrohen drejt përmbushjes së kërkesave të “*acquis*” të Shengenit, duke kontribuar në një sistem më të sigurt dhe më funksional në përputhje me standardet e BE-së.

Në fokus ka:

- sigurinë e brendshme,
- menaxhimin e kufijve dhe migracionit,

- si dhe bashkëpunimin policor dhe luftën kundër krimit të organizuar.

Ky kapitull është i lidhur ngushtë me kapacitetet operacionale të shtetit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, duke qenë veçanërisht relevant për kontekstin e Ballkanit Perëndimor.

Përtej këtyre kapitujve, funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma në administratën publike përbëjnë dimensione horizontale (*cross-cutting*) që ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e të gjitha fushave të tjera. Institucionet demokratike funksionale sigurojnë ndarje reale të pushteteve, mbikëqyrje efektive dhe procese vendimmarrëse gjithëpërfshirëse. Ndërkohë, një administratë publike profesionale dhe e depolitizuar është thelbësore për zbatimin e reformave dhe për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit.

Në këtë kuptim, përvoja rajonale tregon se progresi në Grup Kapituajt 1 nuk varet vetëm nga miratimi i legjislacionit, por mbi të gjitha nga kapaciteti institucional për zbatim, koordinim dhe qëndrueshmëri të reformave.

4. Pamja Rajonale: Ku qëndrojnë vendet sot

Në kuadër të Grup Kapituujve 1 – Parimet Themelore (*Fundamentals*), Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova paraqesin nivele të ndryshme të avancimit, por me sfida të përbashkëta që lidhen kryesisht me zbatimin e reformave dhe mungesën e rezultateve konkrete.

Shqipëria pozicionohet si vendi më i avancuar ndër këto tre vende, duke kaluar nga faza e ndërtimit të kornizës ligjore dhe institucionale drejt konsolidimit dhe prodhimit të rezultateve, veçanërisht në drejtësi. Megjithatë, edhe në këtë fazë, sfidat lidhen me funksionalitetin e plotë të institucioneve dhe thellimin e rezultateve në luftën kundër korrupsionit.

Maqedonia e Veriut ndodhet në një nivel të ndërmjetëm, me një kornizë ligjore relativisht të konsoliduar, por me progres të kufizuar për shkak të zbatimit të dobët dhe ndikimeve politike. Kjo krijon një hendek të qartë ndërmjet reformave të miratuara dhe performancës reale të institucioneve.

Kosova, në krahasim me dy vendet e tjera, mbetet në një fazë më të hershme, e fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe konsolidimin ligjor dhe institucional. Sfida kryesore është mungesa e rezultateve konkrete në sundimin e ligjit dhe kufizimet në kapacitetet administrative.

Pavarësisht progresit të ndryshëm, sfida e përbashkët për të gjitha vendet mbetet transformimi i reformave nga nivel formal në rezultate të matshme dhe të qëndrueshme (*track record*), që është kushti kryesor për avancim në procesin e integritetit në BE.

Vendi	Niveli i përgatitjes	Progresi	Karakteristikat kryesore
Shqipëria	Mesatarisht e avancuar	Është arrite njëfarë progresi	Reforma në drejtësi, rezultate në rritje, nevojë për konsolidim
Maqedonia e Veriut	Mesatarisht e përgatitur	I kufizuar	Kornizë ligjore solide, por zbatim i dobët dhe polarizim politik
Kosova	Fazë e hershme / nivel i kufizuar	I kufizuar	Ndërtim kapacitetesh, mungesë track record në korrupsion

Tabela 1 - Vlerësimi i nivelit të përgatitjes dhe progresit sipas Raporteve të KE.

4.1. Trendi rajonal: progres i ndryshëm me sfida të përbashkëta

Bazuar në raportet e Komisionit Evropian për Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, rajoni karakterizohet nga një progres i diferencuar ndërmjet vendeve, por me sfida të përbashkëta strukturore, veçanërisht në funksionimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit.

Një dallim i rëndësishëm rajonal vihet re ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Shqipëria ka avancuar ndjeshëm në procesin e integritit evropian, duke hapur të gjithë kapitujt për negociata me BE-në, çka e vendos atë në një fazë më konkrete të afrimit me “*acquis*” të BE-së. Ky avancim u konsolidua edhe më tej në shtator 2024, kur Bashkimi Evropian vendosi të ndajë (*decouple*) rugët e integritit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke i dhënë fund qasjes së përbashkët (*package approach*) që kishte qenë në fuqi që nga viti 2020. Si rezultat, Shqipëria ka vazhduar përpara me hapjen dhe avancimin e kapitujve të negociatave.

Në anën tjetër, Maqedonia e Veriut e cila është vend kandidat që nga viti 2005, megjithëse për një kohë të gjatë është konsideruar si më e avancuara në procesin e integritimeve Evropiane, (*front runner*) në rajon për shkak të angazhimit të saj të hershëm në reforma dhe përputhjes së lartë me politikën e jashtme të BE-së, vazhdon të përballet me ngecje në procesin e integritit. Raportet theksojnë se, pavarësisht hapjes së negociatave në vitin 2022 dhe përfundimit në fund të vitit 2023 të procesit të screening¹, vendi mbetet në një situatë bllokimi për shkak të mosmarrëveshjeve bilaterale të pazgjidhura, kryesisht me Bullgarinë, si dhe për shkak të sfidave të brendshme si polarizimi politik, mungesa e konsensusit për reforma kyçe dhe vonesat në ndryshimet kushtetuese që lidhen drejtpërdrejt me avancimin në negociata.

¹ Procesi i ‘screening’ është faza fillestare teknike e negociatave për anëtarësim në BE, ku Komisioni Evropian dhe vendi kandidat analizojnë 33 kapitujt e *acquis* për të vlerësuar gatishmërinë për zbatimin e legjislacionit të BE-së. Ky proces identifikon boshllëqet ligjore dhe përcakton standardet për negociatat e ardhshme. Për më shumë shih vegzën e dokumentit “What is the Screening Process and how does it work?”, November 2022, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a6f16348-ef71-4c99-af55-b58f977322ac_en

Sa i përket Kosovës, gjetjet tregojnë një nivel më të ulët të progresit në shumicën e indikatorëve, veçanërisht në fushën e gjyqësorit, të drejtave themelore dhe luftës kundër korrupsionit, ku vlerësimet mbeten në nivelin "*progres i kufizuar*" ose "*pak progres*". Në këtë drejtim, sfidat kryesore lidhen me mungesën e rezultateve konkrete në praktikë, dobësitë në koordinimin ndërinstitutional dhe problemet në funksionimin e qëndrueshëm të institucioneve kyçe të sistemit të drejtësisë. Megjithatë, vlerësime më pozitive evidentohen në fusha të caktuara si ekonomia e tregut dhe disa elemente të administratës publike, duke reflektuar një progres të pjesshëm dhe të pabarabartë.

Në nivel rajonal, një trend i përbashkët është polarizimi politik dhe mungesa e bashkëpunimit ndërpartiak, që vazhdon të pengojë progresin. Në Kosovë, mungesa e konsensusit politik dhe bojkotet parlamentare kanë ndikuar drejtpërdrejt në miratimin e reformave, ngjashëm edhe në Maqedoninë e Veriut polarizimi ka ndikuar në funksionimin e Kuvendit dhe në vonesat e reformave. Edhe raportet më të fundit konfirmojnë se ndërtimi i konsensusit politik mbetet kyç për përparimin në procesin e integritetit.

Në fushën e sundimit të ligjit, të tri vendet vazhdojnë të përballen me progres të kufizuar, sidomos në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e pavarësisë së gjyqësorit. Në Kosovë, progresi mbetet i kufizuar dhe kërkohet zbatim më efektiv i legjislacionit, ndërsa në Maqedoninë e Veriut korrupsioni mbetet problem serioz dhe reformat në drejtësi kanë avancuar ngadalë. Në Shqipëri, megjithëse është arritur njëfarë progresi përmes reformës në drejtësi dhe funksionimit të institucioneve të specializuara, sfida vazhdon të mbetet konsolidimi i rezultateve dhe krijimi i një historiku të qëndrueshëm në ndjekjen e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë.

Një tjetër element i përbashkët është dobësia në administratën publike dhe zbatimin e reformave. Në Kosovë progresi është i kufizuar dhe shpesh mungon implementimi efektiv, ndërsa në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, megjithëse ka korniza ligjore të avancuara, zbatimi mbetet i pjesshëm dhe i ngadalshëm.

Gjithashtu, një sfidë e përbashkët mbetet kapaciteti institucional dhe zbatimi i reformave në përgjithësi. Edhe kur ekziston korniza ligjore, si në rastin e Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, implementimi shpesh mbetet i pjesshëm dhe i ngadalshëm, duke kufizuar efektet reale të reformave.

Në përfundim, rajoni karakterizohet nga një progres i pabarabartë, ku disa vende avancojnë më shpejt në aspektin formal të integritetit, ndërsa të tri këto vende përballen me sfida pothuajse të njëjta në praktikë. Përparimi i qëndrueshëm drejt BE-së kërkon jo vetëm hapa proceduralë, por mbi të gjitha konsensus politik, forcim të institucioneve dhe zbatim efektiv të reformave. Procesi i integritetit në BE nuk varet më vetëm nga reformat teknike, por gjithnjë e më shumë edhe nga faktorë politikë si brenda vendeve, ashtu edhe në raport me shtetet anëtare.

Kategoria	Shqipëria	Maqedonia e Veriut	Kosova
Trendi i përgjithshëm	Progres gradual dhe konsolidues	Stagnim relativ me luhatje	Progres i kufizuar konstant apo minimal
Pozicioni në proces	Negociata – kapituj të hapur	Negociata–screening/ bllokim	Fazë përgatitore
Zhvillime kyçe politike	Në fund të vitit 2025 ka hapur të gjithë kapitujt për negociim	2024: BE ndau procesin e integritit nga Shqipëria për shkak të bllokadave (Bullgaria)	2022-aplikon për statusin kandidat; 2025-ende pa përgjigje
Sfida kryesore	Nevojë për rezultate konkrete dhe konsolidim institucional	Polarizim politik, kushtëzime bilaterale, zbatim i dobët	Zbatim i dobët, mungesë track record, kapacitete të kufizuara

Tabela 2 - Krahësimi i progresit dhe sfidave në procesin e integritit në BE.

4.2. Pozicioni dhe roli i BE në ofrimin e një qasje të qartë të integritimeve

Bashkimi Evropian luan një rol qendror në përcaktimin e drejtimit dhe standardeve të procesit të integritit për të gjitha vendet aspirantë përfshi edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, përmes një kornize të strukturuar që bazohet në kritere të qarta dhe të matshme. Në këtë kuadër, procesi i zgjerimit ofron një udhërrëfyes të mirë definuar reformash, veçanërisht përmes Grup Kapitujve 1 – Parimet Themelore, duke vendosur prioritet në sundimin e ligjit, funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformën në administratën publike.

Nga perspektiva e dekadës së kaluar, fenomeni i ashtuquajtur “*enlargement fatigue*” brenda Bashkimit Evropian ka ndikuar në uljen e qartësisë dhe parashikueshmërisë së procesit të integritit për vendet aspirante. Gjatë kësaj periudhe, politika e zgjerimit u karakterizua nga një qasje më e rezervuar, ku BE-ja i dha prioritet konsolidimit të brendshëm institucional dhe politik. Kjo u reflektua shpesh në qëndrimin se thellimi i integritit të brendshëm duhet t’i paraprijë zgjerimit, duke ngadalësuar kështu dinamiken e procesit të anëtarësimit për vendet e rajonit².

Ky fenomen ka qenë veçanërisht i theksuar në periudhën 2010–2022. Një shembull ilustrues është Shqipëria, e cila mori statusin e vendit kandidat që në vitin 2014, por vendimi për hapjen e negociatave u shty deri në vitin 2022, pavarësisht progresit të vazhdueshëm në reforma. Ngjashëm, Maqedonia e Veriut, megjithëse për një kohë të gjatë konsiderohej si një nga vendet më të

² European Commission, Communication on EU Enlargement Policy, COM(2019) 260 final, Brussels, 29 May 2019; shih gjithashtu European Commission, Enhancing the accession process – A credible EU perspective for the Western Balkans, COM(2020) 57 final, Brussels, 5 February 2020.

përgatitura për integrim, është përballur me vonesa të konsiderueshme për shkak të dinamikave të brendshme të BE-së dhe kushtëzimeve shtesë bilaterale. Kjo qasje rezultoi në një lloj pasigurie dhe pakënaqësie tek vendet e rajonit, duke kontribuar në rritjen e skepticizmit ndaj procesit të integritit, forcimin e diskurseve populiste dhe rritjen e rezistencës ndaj kushteve dhe kriterëve të vendosura nga BE-ja³.

Megjithatë, zhvillimet e fundit globale si pushtimi ilegal i Ukrainës nga Rusia dhe tensionet në Lindjen e Mesme kanë rikthyer rëndësinë gjeopolitike të zgjerimit, duke e shtyrë Bashkimin Evropian drejt një qasjeje më proaktive ndaj Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst, rajoni po shihet gjithnjë e më shumë nga prizmi i stabilitetit dhe sigurisë, ku Bashkimi Evropian ka rritur angazhimin ndaj rajonit, duke reflektuar një qasje më proaktive dhe më politike ndaj integritit të Ballkanit Perëndimor, por duke ruajtur në të njëjtën kohë standardet dhe kriteret e avancuara të anëtarësimit⁴.

Prandaj mund të thuhet që roli i Bashkimit Evropian nuk është vetëm normativ, por edhe katalizues dhe kushtëzues i reformave për vendet aspirante. Në këtë drejtim, raportet e Komisionit Evropian për të tri vendet ofrojnë një vlerësim të vazhdueshëm dhe të standardizuar të performancës së vendeve, duke identifikuar në mënyrë sistematike hendekun ndërmjet angazhimeve politike dhe rezultateve reale në praktikë. Për shembull në rastin e Kosovës, ky hendek mbetet i dukshëm, duke reflektuar një situatë ku ekziston një orientim i qartë strategjik drejt Bashkimit Evropian, por njëkohësisht vendi vazhdon të ballafaqohet me sfida serioze në zbatim dhe funksionim institucional.

Në të njëjtën kohë, dinamika e fundit e zgjerimit tregon një transformim të qasjes së BE-së, e cila po kalon drejt një modeli më pragmatik dhe më të diferencuar. Vendimi për të ndarë rrugët e integritit ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut reflekton këtë zhvendosje, duke kaluar nga qasja rajonale e paketuar drejt një qasjeje më meritokratike, ku progresi individual i vendeve përcakton ritmin e avancimit.

Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së një kornize të qartë, sfida mbetet në parashikueshmërinë dhe konsistencën e procesit. Kushtëzimet politike, çështjet bilaterale dhe dinamika e brendshme e Bashkimit Evropian shpesh ndikojnë në ritmin e integritit, duke krijuar siguri apo pasiguri për vendet aspiruese.

³ Balkans in Europe Policy Advisory Group (BiEPAG), The EU and the Western Balkans: From Enlargement Fatigue to Strategic Engagement, 2021.

⁴ European Commission, EU Enlargement Package 2023; European Council Conclusions, 23–24 June 2022

Në këtë kontekst, roli i Bashkimit Evropian është i dyfishtë:

- nga njëra anë, të ofrojë një kornizë të qartë, të besueshme dhe të bazuar në meritë;
- dhe nga ana tjetër, të sigurojë që procesi të mbetet i parashikueshëm dhe i drejtë, duke shmangur ndikimet e faktorëve politikë që tejkalojnë performancën reale të vendeve.

Në përfundim, mund të thuhet se e ardhmja e procesit të integrimit evropian në Ballkanin Perëndimor do të varet nga aftësia e Bashkimi Evropian për të ruajtur një ekuilibër të qëndrueshëm ndërmjet qasjes meritokratike dhe realiteteve politike, duke garantuar një proces të besueshëm, të parashikueshëm dhe të drejtë. Në të njëjtën kohë, përgjegjësia mbetet edhe te vendet aspiruese që të kalojnë nga angazhimet formale drejt rezultateve konkrete dhe të qëndrueshme në praktikë. Vetëm përmes këtij kombinimi të përgjegjësisë së ndërsjellë mund të rikthehet besimi në proces dhe të sigurohet që integrimi evropian të mbetet një perspektivë reale dhe motivuese për rajonin.

4.3. Plani i Rritjes

Plani i Rritjes i Bashkimi Evropian për Ballkanin Perëndimor përfaqëson një qasje të re dhe më pragmatike ndaj procesit të zgjerimit, duke synuar që integrimi i vendeve të rajonit të mos mbetet vetëm një perspektivë politike afatgjate, por të prodhojë përfitime konkrete dhe të matshme që në fazat e hershme. Përmes Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike, ky plan lidh drejtpërdrejt zbatimin e reformave me mbështetjen financiare dhe integrimin gradual në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian.

Në thelb, Plani synon të përshpejtojë konvergjencën ekonomike dhe institucionale të rajonit me Bashkimin Evropian, duke përfshirë objektiva ambicioze si dyfishimi i ekonomive të vendeve të Ballkanit Perëndimor brenda një dekade. Ai mbështetët në katër shtylla kryesore:

- a) integrimin ekonomik me tregun e BE-së;
- b) forcimin e tregut të përbashkët rajonal;
- c) zbatimin e reformave themelore për anëtarësim; dhe
- d) ofrimin e mbështetjes financiare të kushtëzuar nga performanca në reforma.

Paketa financiare prej 6 miliardë eurosh shpërndahet mbi bazën e rezultateve konkrete të vendeve në përmbushjen e reformave.⁵

Kjo qasje reflekton një ndryshim thelbësor në logjikën e zgjerimit: nga një proces i bazuar në harmonizim ligjor drejt një modeli që kërkon zbatim real dhe rezultate të matshme në praktikë. Në këtë kuadër, performanca e vendeve të

⁵ Për më shumë shih: https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/growth-plan-western-balkans_en

rajonit në zbatimin e Planit të Rritjes është e pabarabartë dhe reflekton dallimet ekzistuese në kapacitetet institucionale dhe stabilitetin politik.

Në rastin e Kosovës, ndonëse Agjenda e Reformave 2024–2027 është negociuar dhe miratuar në tetor 2024, zbatimi i Planit të Rritjes është karakterizuar nga vonesa të konsiderueshme. Këto vonesa lidhen drejtpërdrejt me zhvillimet politike gjatë vitit 2025, i cili është vlerësuar si një “vit i humbur” për reformat për shkak të bllokadave institucionale dhe mosfunksionimit efektiv të institucioneve.⁶ Megjithëse marrëveshjet në kuadër të Planit të Rritjes u ratifikuan nga Kuvendi në fillim të vitit 2026, periudha paraprake e stagnimit ka shkaktuar një humbje substanciale kohe në fazat fillestare të implementimit. Zhvillimet politike pas zgjedhjeve të fund vitit 2025, përfshirë vështirësitë në funksionimin e institucioneve, paraqesin rrezik shtesë për ritmin e zbatimit të reformave. Si rrjedhojë, Kosova ndodhet aktualisht në një fazë fillestare të zbatimit, me progres të kufizuar dhe me rrezik real që, për shkak vonesave dhe kapaciteteve të kufizuara absorbuuese, të mos shfrytëzojë plotësisht fondet e alokuara.

Në anën tjetër, Shqipëria paraqet një trajektore më të avancuar në zbatimin e Planit të Rritjes. Duke qenë në fazë negociatash me Bashkimin Evropian dhe me një bazë më të konsoliduar reformash, Shqipëria ka kapacitete më të zhvilluara institucionale për të zbatuar Agjendën e Reformave dhe për të përfituar nga mekanizmat financiarë të Planit. Kjo reflektohet edhe në performancën konkrete ku deri në korrik 2025, Shqipëria kishte arritur të zbatojë 38 nga 41 hapat e kërkuar në kuadër të marrëveshjes, duke u pozicionuar si një nga vendet më të avancuara në rajon në aspektin e implementimit. Si rrjedhojë, Shqipëria deri në mars të 2025 ka përfituar rreth 163.8 milionë euro nga fondet e Planit të Rritjes, ndërkohë që disbursimet e para nga Bashkimi Evropian konfirmojnë lidhjen direkte ndërmjet performancës në reforma dhe mbështetjes financiare. Për më tepër, vlerësimet ndërkombëtare për qeverisjen dhe transformimin politik e pozicionojnë Shqipërinë ndër vendet më të avancuara në rajon.

Maqedonia e Veriut, paraqet sot një situatë më komplekse, e karakterizuar nga një kontrast ndërmjet kapaciteteve ekzistuese dhe performancës reale në zbatim. Nga njëra anë, vendi ka një kornizë të konsoliduar reformash dhe kapacitete institucionale relativisht të mira për zbatimin e Planit të Rritjes, gjë që reflektohet edhe në përfitimet financiare konkrete, ku deri më tani ka përfituar rreth 68 milionë euro në kuadër të këtij instrumenti⁷. Nga ana tjetër, stagnimi politik, polarizimi i brendshëm dhe bllokatat e lidhura me procesin e integritetit kanë ndikuar drejtpërdrejt në ritmin dhe konsistencën e reformave. Si rezultat, edhe pse potenciali për avancim mbetet i lartë, progresi karakterizohet nga fragmentim dhe paqëndrueshmëri, duke reflektuar një

⁶ Draft raporti i Komitetit për Punë të Jashtme i Parlamentit Evropian i datës 06 mars 2026 e quan vitin 2025 si vit të humbur për Kosovën në procesin e integriteteve evropiane. Ky raport është draft dhe ende nuk është publikuar në faqen zyrtare të Parlamentit Evropian

⁷ Reform Monitor (2025), RGF Payment Annex – North Macedonia

situatë ku kapaciteti institucional nuk përkthehet në mënyrë të qëndrueshme në rezultate konkrete në praktikë.

Në mënyrë krahasimore, analiza e zbatimit të Planit të Rritjes evidenton tre trajektore të ndryshme në rajon. Shqipëria si vend në fazë konsolidimi dhe zbatimi më të avancuar, Maqedonia e Veriut si vend me potencial të lartë, dhe Kosova si vend në fazë fillestare, me sfida të theksuara institucionale dhe zbatuese.

5. Përfundime kryesore nga punëtoritë

Në kuadër të përpjekjeve për të mbështetur procesin e integritit evropian në rajon, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), në bashkëpunim me organizatat partnere SCOOP nga Maqedonia e Veriut dhe Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) nga Shqipëria, ka organizuar një seri punëtorish rajonale me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile, zyrtarëve institucionalë dhe ekspertëve të fushës. Punëtoritë, të mbajtura në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, janë fokusuar në analizimin e progresit dhe sfidave në zbatimin e reformave në kuadër të Grup Kapitujve 1 Parimet Themelore, me theks në sundimin e ligjit dhe funksionimin e institucioneve.

Diskutimet kanë nxjerrë në pah se procesi i integritit nuk është vetëm një proces teknik i harmonizimit ligjor, por kërkon zbatim efektiv të reformave dhe rezultate konkrete në praktikë, përmes forcimit të institucioneve, rritjes së llogaridhënies dhe përfshirjes së aktorëve relevantë në proces.

5.1. Përfundimet nga punëtorja në Tiranë

Gjetjet nga punëtorja e mbajtur në Tiranë reflektojnë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj procesit të integritit evropian, duke theksuar se ky proces nuk duhet të trajtohet vetëm si një ushtrim teknik i harmonizimit ligjor, por si një transformim i thellë institucional dhe shoqëror. Në këtë drejtim, u theksua se procesi i "europeanizimit" zhvillohet paralelisht me negociatat dhe përfshin jo vetëm përafrimin e legjislacionit, por edhe internalizimin e vlerave të sundimit të ligjit, llogaridhënies dhe përfshirjes shoqërore.

Një nga gjetjet kryesore lidhet me rëndësinë e përfshirjes së aktorëve të ndryshëm në procesin e integritit, veçanërisht të shoqërisë civile, e cila është identifikuar si një aktor strategjik në monitorimin e reformave dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Në këtë kontekst, u theksua se mekanizmat e strukturuar, si Platforma për Grup Kapitujt 1 Parimet Themelore, kontribuojnë në përmirësimin e debatit publik dhe në përfshirjen më të gjerë të akterëve profesionalë në proces.

Megjithatë, u vlerësua se progresi në disa fusha të sundimit të ligjit, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, mbetet i kufizuar, ndërsa mungesa e llogaridhënies demokratike vazhdon të ndikojë në stagnimin e reformave. Në këtë drejtim, u theksua nevoja për mobilizim më të madh të akterëve shoqërorë për të ushtruar presion ndaj institucioneve për zbatimin efektiv të reformave.

Në raport me Kosovën, u theksua se vendi ndodhet në një fazë fillestare të procesit të integritetit, duke u mbështetur kryesisht në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe pa avancim në stad më të lartë të procesit. Derisa u tha se përvoja e Shqipërisë demonstroi se hapja e kapitujve shënon vetëm fillimin e një faze më kërkuese të reformave, ndërsa faktorë si qëndrueshmëria politike, vazhdimësia institucionale dhe konsensusi politik janë thelbësorë për avancimin e procesit.

Gjithashtu, u theksua se procesi i integritetit për Kosovën mbetet i ndërlidhur me zhvillimet në politikën e jashtme, veçanërisht me dialogun me Serbinë, duke e bërë avancimin në këtë proces të kushtëzuar nga faktorë politikë dhe ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, u identifikua mungesa e një qasjeje të qëndrueshme dhe të koordinuar institucionale si një ndër sfidat kryesore për përparimin në integritetin evropian.

Në kuadër të diskutimeve, u konsiderua gjithashtu rëndësia e kuptimit të strukturës institucionale dhe mekanizmave të vendimmarrjes së Bashkimit Evropian, si parakusht për një pjesëmarrje efektive në procesin e integritetit. U theksua se funksionimi i sistemit institucional të Bashkimit Evropian kërkon jo vetëm përafrim ligjor, por edhe ndërtim të kapaciteteve administrative dhe institucionale për zbatim efektiv të “*acquis*” dhe përfshirje aktive në proceset vendimmarrëse.

Në përgjithësi, gjetjet nga punëtoria në Tiranë nënvizojnë se avancimi në procesin e integritetit evropian kërkon një qasje të koordinuar, përfshirëse dhe të qëndrueshme, e cila kombinon reformën ligjore me forcimin e institucioneve, rritjen e llogaridhënies dhe përfshirjen aktive të aktorëve të ndryshëm në proces.

5.2. Përfundimet nga punëtoria në Prishtinë

Gjetjet nga punëtoria e mbajtur në Prishtinë theksojnë rëndësinë qendrore të sundimit të ligjit dhe funksionimit efektiv të institucioneve në procesin e integritetit evropian, duke reflektuar një fokus më të theksuar në performancën konkrete në Kapitujt 23 dhe 24. Në këtë drejtim, u tha se metodologjia e re e zgjerimit të Bashkimit Evropian e vendos progresin në Grup Kapitujt Themelore si përcaktues për avancimin në të gjitha fushat tjera të negociatave.

Nga përvoja e Shqipërisë, u theksua se, përkundër përparimeve të arritura në procesin e negociatave, përfshirë hapjen e të gjithë kapitujve dhe zbatimin e reformës në drejtësi përmes procesit të vettingut, mbeten sfida të rëndësishme në sigurimin e rezultateve të qëndrueshme në praktikë, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional.

Në të njëjtën kohë, u vlerësua se progresi i Maqedonisë së Veriut mbetet i kufizuar, me mungesë përmirësimesh të dukshme në funksionimin e gjyqësorit dhe në luftën kundër korrupsionit, ndërsa zbatimi i kornizës ligjore vazhdon të jetë sfida. U theksua se mungesa e rezultateve konkrete dhe kapacitetet e pamjaftueshme institucionale vazhdojnë të pengojnë avancimin drejt standardeve të Bashkimit Evropian.

Sa i përket Kosovës, u vu në pah se progresi në kuadër të Grup Kapituljeve 1 Parimet Themelore mbetet i kufizuar, me sfida të theksuara në sigurimin e një "track record"-i të qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë drejtim, u theksua se ndërhyrjet dhe presioni publik ndaj gjyqësorit, mungesa e stabilitetit në sistemin prokurorial dhe fragmentimi institucional ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë.

Gjithashtu, u konsiderua se bashkëpunimi ndërinstitutional në trajtimin e rasteve komplekse mbetet i kufizuar, ndërsa moszbatimi i vendimeve gjyqësore dhe i reformave në praktikë vazhdon të cenojë besueshmërinë e institucioneve dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Në kuadër të diskutimeve, u theksua edhe roli i shoqërisë civile në mbështetjen e procesit të integritetit, përmes monitorimit të reformave dhe kontributit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, megjithëse përfshirja e saj vazhdon të përballet me sfida që lidhen me kapacitetet dhe funksionalizimin e mekanizmave ekzistues të bashkëpunimit.

Në përgjithësi, gjetjet nga punësitoria në Prishtinë nënvizojnë se sfida kryesore për vendet e rajonit mbetet kalimi nga përputhshmëria formale drejt zbatimit efektiv të reformave, përmes forcimit të institucioneve, rritjes së koordinimit ndërinstitutional dhe sigurimit të rezultateve konkrete në fushën e sundimit të ligjit.

5.3. Përfundimet nga punësitoria në Shkup

Gjetjet nga punësitoria e mbajtur në Shkup theksojnë ndërlidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe performancës institucionale në procesin e integritetit evropian, duke nënvizuar se përmbushja e kriterëve politike nuk mund të trajtohet në mënyrë të ndarë nga funksionimi efektiv i institucioneve. Në këtë drejtim, u konstatua se përkundër përkushtimit të deklaruar në nivel politik ndaj bashkëpunimit rajonal, mbetet i theksuar hendeku ndërmjet angazhimeve dhe zbatimit të tyre në praktikë.

Sa i përket Kosovës, u theksua se progresi në fushën e sundimit të ligjit mbetet i kufizuar dhe kryesisht në nivel legjislativ, ndërsa zbatimi në praktikë vazhdon të jetë i dobët dhe jo konsistent. U vu në pah se mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, boshllëqet në funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe mungesa e stabilitetit institucional ndikojnë drejtpërdrejt në performancën e përgjithshme institucionale. Në këtë kontekst, u theksua se edhe çështje si moszbatimi i vendimeve gjyqësore dhe i reformave administrative kontribuojnë në dobësimin e sundimit të ligjit dhe në rritjen e ngarkesës së sistemit.

Në aspektin e administratës publike, u konstatua stagnim në zbatimin e reformave dhe sfida të vazhdueshme në sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritokraci. U theksua se pasiguria juridike dhe kontestimet e shpeshta të legjislacionit ndikojnë negativisht në funksionimin e institucioneve dhe në besueshmërinë e tyre.

Në kuadër më të gjerë, u theksua se marrëdhëniet e mira fqinjësore përbëjnë një komponent thelbësor të procesit të integritit evropian dhe janë të ndërlidhura ngushtë me politikën e jashtme dhe të sigurisë së Bashkimit Evropian. U vlerësua se përafrimi me politikat e Bashkimit Evropian në këtë fushë, përfshirë Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë dhe Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, është i domosdoshëm për avancimin në procesin e integritit.

Gjithashtu, u theksua se bashkëpunimi rajonal dhe ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme fqinjësore kërkojnë jo vetëm angazhim politik, por edhe institucione funksionale dhe kapacitete administrative të zhvilluara. Në këtë drejtim, u konsiderua se performanca institucionale dhe administrata publike luajnë rol kyç në zbatimin efektiv të “*acquis*” të Bashkimit Evropian dhe në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit.

Në përgjithësi, gjetjet nga punëtorja në Shkup nënvizojnë se avancimi në procesin e integritit evropian varet nga aftësia e vendeve për të siguruar një ndërlidhje të qëndrueshme ndërmjet bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit efektiv të institucioneve, përmes forcimit të sundimit të ligjit, rritjes së kapaciteteve administrative dhe zbatimit të qëndrueshëm të reformave në praktikë.

6. Specifikat e vendeve të rajonit

Bazuar në raportet e Komisioni Evropian, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, dhe Kosova paraqesin nivele të ndryshme të integritit në kuadër të Grup Kapituive 1 – Parimet Themelore, edhe pse ndajnë sfida të përbashkëta që lidhen me zbatimin e reformave dhe funksionimin institucional.

Shqipëria – ka kaluar fazën e ndërtimit të kornizës ligjore dhe institucionale, por sfida kryesore mbetet deficiti i zbatimit dhe mungesa e rezultateve të konsoliduara. Pavarësisht reformave të thella, veçanërisht në drejtësi, sistemi vazhdon të karakterizohet nga një hendek i vazhdueshëm ndërmjet arkitekturës institucionale dhe performancës reale.

e) **Sundimi i ligjit** – Shqipëria vazhdon të përballet me një “*track record*” të pamjaftueshëm dhe të paqëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, duke kufizuar efektin real të reformës në drejtësi. Megjithëse institucionet e reja janë funksionale, ato mbeten ende në fazë konsolidimi dhe varen më shumë nga kapacitetet individuale sesa nga mekanizma të qëndrueshëm sistemikë. Në të njëjtën kohë, efikasiteti operacional mbetet i ulët, i reflektuar në zgjatjen e proceseve gjyqësore dhe “*backlog*”-un e rasteve, ndërsa zbatimi i vendimeve gjyqësore vazhdon të jetë selektiv dhe jo konsistent.

f) **Lufta kundër korrupsionit** – Shqipëria vazhdon të përballet me një nivel të lartë të korrupsionit, veçanërisht në nivelet e larta, ku rezultatet mbeten të kufizuara dhe jo të qëndrueshme. Përpjekjet institucionale shpesh mbeten të fragmentuara, me fokus në raste individuale, pa krijuar një qasje të konsoliduar parandaluese dhe ndëshkuese. Gjithashtu, hetimet financiare dhe konfiskimi i

pasurisë nuk kanë arritur ende një nivel të mjaftueshëm efektiviteti për të krijuar ndikim sistemik.

g) **Funksionimi i institucioneve demokratike** – Funksionimi i institucioneve vijon të ndikohet nga polarizimi i thellë politik, i cili kufizon dialogun konstruktiv dhe zbatimin e reformave. Roli mbikëqyrës i Kuvendit mbetet i dobët, ndërsa proceset e llogaridhënies shpesh janë formale dhe jo substanciale, duke ndikuar në transparencën dhe efektivitetin e vendimmarrjes.

h) **Administrata publike** – Pavarësisht një kornize ligjore të zhvilluar, administrata publike vazhdon të karakterizohet nga zbatim i pjesshëm i reformave dhe ndikim i vazhdueshëm politik. Sfida në sigurimin e meritokracisë dhe stabilitetit të stafit mbeten të pranishme, ndërsa kapacitetet profesionale dhe menaxheriale nuk janë të konsoliduara në mënyrë të qëndrueshme.

i) **Të drejtat themelore** – Shqipëria ka bërë progres në aspektin normativ, por sfidat mbeten në zbatimin praktik të të drejtave themelore. Mbrojtja e grupeve të cënueshme është e kufizuar, ndërsa mjedisi për median dhe gazetarët mbetet i brishtë, duke reflektuar presione të vazhdueshme dhe mungesë të garancive të plota për ushtrimin e lirë të profesionit.

Maqedonia e Veriut – paraqet një kornizë ligjore dhe institucionale relativisht të konsoliduar, por sfida kryesore mbetet zbatimi i dobët dhe jo konsistent i reformave. Progresi karakterizohet nga luhajtje dhe stagnim i pjesshëm, i ndikuar nga polarizimi politik dhe mungesa e konsensusit për reforma kyçe, si dhe nga faktorë të jashtëm që kanë ngadalësuar procesin e integritetit.

a) **Sundimi i ligjit** – Maqedonia e Veriut vazhdon të përballlet me sfida në garantimin e pavarësisë dhe funksionimit efektiv të gjyqësorit, ku ndërhyrjet politike dhe presionet institucionale mbeten shqetësim. Efikasiteti i sistemit të drejtësisë është i kufizuar, ndërsa rezultatet në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë mbeten të pamjaftueshme dhe jo bindëse në krijimin e një “*track record*” të qëndrueshëm.

b) **Lufta kundër korrupsionit** – Pavarësisht ekzistencës së institucioneve dhe mekanizmave përkatës, korrupsioni vazhdon të mbetet problem serioz, me zbatim të dobët dhe rezultate të kufizuara. Mungesa e ndëshkueshmërisë konsistente dhe ndërhyrjet politike ndikojnë në efektivitetin e politikave kundër korrupsionit.

c) **Funksionimi i institucioneve demokratike** – Polarizimi i thellë politik vazhdon të ndikojë në funksionimin e institucioneve dhe në stabilitetin e proceseve reformuese. Dialogu politik mbetet i brishtë, ndërsa proceset vendimmarrëse shpesh pengohen nga mungesa e konsensusit ndërpartiak.

d) **Administrata publike** – Administrata publike përballlet me sfida në depolitizim dhe në sigurimin e meritokracisë. Edhe pse ekziston një kornizë e zhvilluar ligjore, zbatimi i saj mbetet i pjesshëm, ndërsa kapacitetet administrative dhe menaxheriale nuk janë të konsoliduara në mënyrë të qëndrueshme.

e) **Të drejtat themelore** – Zbatim praktik i të drejtave themelore mbetet i pabarabartë, ndërsa mbrojtja e grupeve të cënueshme dhe funksionimi i plotë i mekanizmave mbrojtës kërkojnë përmirësim. Mjedisi për media dhe liria e shprehjes vazhdojnë të përballen me sfida strukturore.

Kosova – ndodhet në një fazë më të hershme të zhvillimit në kuadër të Grup Kapitujve 1 – Parimet Themelore, me sfida të theksuara në zbatim, koordinim institucional dhe ndërtim kapacitetesh. Hendeku ndërmjet angazhimeve reformuese dhe rezultateve konkrete mbetet i theksuar, duke reflektuar një proces të paqëndrueshëm dhe të fragmentuar të reformave.

a) Sundimi i ligjit – Kosova vazhdon të përballet me sfida serioze në funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë, përfshirë mungesën e rezultateve të qëndrueshme në korrupsion të nivelit të lartë. Kapacitetet institucionale mbeten të kufizuara, ndërsa zbatimi i ligjit shpesh është i paqëndrueshëm dhe jo konsistent.

b) Lufta kundër korrupsionit – Korrupsioni mbetet problem i përhapur, me mungesë të një “*track record*”-i bindës në ndjekjen penale dhe ndëshkimin e rasteve të profilin të lartë. Mekanizmat parandalues dhe ndëshkues janë të fragmentuar dhe me ndikim të kufizuar në praktikë.

c) Funksionimi i institucioneve demokratike – Sfida në koordinimin institucional dhe në funksionimin e qëndrueshëm të institucioneve vazhdojnë të jenë të pranishme. Proceset vendimmarrëse shpesh karakterizohen nga mungesë konsistence dhe bashkëpunimi ndërinstitutional.

d) Administrata publike – Reformat në administratën publike mbeten të papërfunduara dhe të paqëndrueshme, të shoqëruara me paqartësi ligjore dhe ndërhyrje institucionale. Kapacitetet administrative janë të kufizuara, ndërsa stabiliteti dhe profesionalizmi i shërbimit civil mbeten sfidë.

e) Të drejtat themelore – Zbatimi i të drejtave themelore mbetet i dobët në praktikë, me sfida në mbrojtjen e grupeve të cënueshme dhe në garantimin e barazisë. Mjedisi për media dhe transparenca institucionale vazhdojnë të kërkojnë përmirësim të ndjeshëm.

Fusha / Kapitulli	Shqipëria	Maqedonia e Veriut	Kosova
Funksionimi i institucioneve demokratike	3–4	3	2
Reforma në administratën publike	3–4	3	2–3
Kapitulli 23 (Gjyqësori & të drejtat themelore)	4	3	2
Kapitulli 24 (Drejtësia, siguria)	4	3	2–3
Lufta kundër korrupsionit	4	2–3	2
Mesatarja e përgjithshme për Grup Kapituj 1	4	3	2–2.5

Tabela 3 - Vlerësimi i nivelit të përgatitjes dhe progresit sipas fushave të Grup Kapitujve 1⁸

⁸ Për qëllime krahasuese, vlerësimet cilësore të Komisioni Evropian janë konvertuar në një shkallë numerike 1–5 (nga kthim prapa deri te progres i mirë). Në bazë të kësaj metodologjie, tabela më lartë paraqet progresin e vlerësuar nga Komisioni Evropian për të tri vendet.

Në mënyrë krahasimore, të tri vendet ilustrojnë faza të ndryshme të të njëjtit proces:

- Shqipëria → fazë konsolidimi dhe rezultate;
- Maqedonia e Veriut → fazë kornize të vendosur, por zbatim i dobët;
- Kosova → fazë ndërtimi kapacitetesh dhe implementim i kufizuar.

Megjithatë, një tipar i përbashkët mbetet i qartë: problemi nuk është tek mungesa e legjislationit, por mungesa e zbatimit dhe rezultateve konkrete. Kjo e bën Grup Kapituajt 1 jo vetëm një kriter teknik, por një test të drejtpërdrejtë të funksionalitetit të shtetit dhe besueshmërisë së institucioneve në rajon.

6.1. Shqipëria: Nga reforma në negociata

Në kuadër të Grup Kapituajve 1 – Themeloret, Shqipëria ka shënuar progres të qëndrueshëm dhe të matshëm, duke kaluar nga një fazë intensive e nxitur nga reformat – veçanërisht e shënuar nga reforma gjithëpërfshirëse në drejtësi e nisur në vitin 2016 – drejt një faze më të avancuar, të karakterizuar nga negociata aktive dhe hapja e të gjithë kapitujve deri në fund të vitit 2025. Ky tranzicion pasqyron jo vetëm përfundimin e reformave kyçe strukturore, por edhe rritjen e kapaciteteve administrative dhe politike të Shqipërisë për t'iu përgjigjur kërkesave teknike të procesit të anëtarësimit.

Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian për vitin 2025, Shqipëria mbetet në nivel mesatar të përgatitjes, me progres të vazhdueshëm, por jo të njëtrajtshëm në komponentët e Grupkapitullit 1. Përparimet më të dukshme vërehen në fushën e sundimit të ligjit, veçanërisht në kuadër të reformës në drejtësi dhe përpjekjeve kundër korrupsionit. Procesi i vettingut ka transformuar ndjeshëm sistemin gjyqësor përmes largimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kompromentuar, duke rritur kështu integritetin institucional dhe pavarësinë formale. Paralelisht, institucionet e specializuara, veçanërisht Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK), kanë forcuar kapacitetet hetimore dhe ndjekëse penale, përfshirë edhe në rastet që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë.

Megjithatë, Komisioni thekson se qëndrueshmëria dhe kredibiliteti i këtyre reformave tashmë varen nga arritja e rezultateve konkrete dhe të qëndrueshme, veçanërisht sa i përket dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar, si dhe konfiskimit efektiv të pasurisë së paligjshme. Hendeku aktual ndërmjet ristrukturimit institucional dhe rezultateve të matshme mbetet shqetësim thelbësor, duke treguar se Shqipëria po hyn në një fazë ku performanca, e jo përputhshmëria formale, bëhet kriteri kryesor i vlerësimit.

Sa i përket funksionimit të institucioneve demokratike, Shqipëria ruan stabilitet të përgjithshëm institucional, me procese zgjedhore të rregullta dhe rend kushtetues funksional. Megjithatë, cilësia e qeverisjes demokratike vazhdon të ndikohet nga polarizimi i vazhdueshëm politik, i cili kufizon dialogun konstruktiv, dobëson rolin mbikëqyrës të Kuvendit ndaj ekzekutivit dhe ndikon në përfshirjen në procesin legjislativ. Edhe pse Kuvendi përmbush rolin e tij formal ligjvënës, kapaciteti i tij për të ushtruar kontroll efektiv ndaj pushtetit ekzekutiv

mbetet i kufizuar, duke reflektuar një problem më të gjerë të balancës së pushteteve.

Në fushën e reformës në administratën publike, Shqipëria ka shënuar progres në miratimin e kornizave strategjike dhe përmirësimin e procedurave formale lidhur me rekrutimin dhe standardet profesionale. Megjithatë, Komisioni vazhdon të theksojë sfida strukturore që lidhen me politizimin, kapacitetet e kufizuara administrative dhe zbatimin e pamjaftueshëm të parimit të meritokracisë. Këto çështje ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe paanshmërinë e zbatimit të politikave, duke reflektuar në efektivitetin e përgjithshëm të qeverisjes.

Rruga e Shqipërisë në procesin e integritit evropian ka qenë graduale, por me një përshpejtim të dukshëm në vitet e fundit. Pas marrjes së statusit të vendit kandidat në vitin 2014, vendi hyri në një periudhë të zgjatur kushtëzimi të fokusuar në reformën në drejtësi dhe stabilizimin politik. Hapja e negociatave të anëtarësimit në vitin 2022, e ndjekur nga progresi i shpejtë në procesin e “screening”-ut dhe hapja e kapitujve, pasqyron si përpjekjet e brendshme reformuese, ashtu edhe një qasje më strategjike dhe gjeopolitike të Bashkimit Evropian ndaj zgjerimit në Ballkanin Perëndimor.

Në fazën aktuale, Shqipëria nuk vlerësohet më kryesisht për aftësinë e saj për të miratuar legjislacion apo për të krijuar institucione, por për kapacitetin për të konsoliduar reformat dhe për të siguruar zbatimin e tyre efektiv, të paanshëm dhe të qëndrueshëm. Kjo përfshin forcimin e rezultateve konkrete në sundimin e ligjit, përmirësimin e llogaridhënies demokratike dhe garantimin e një administrate publike profesionale dhe të depolitizuar.

Në këtë kontekst, fokusi i Bashkimit Evropian është zhvendosur qartësisht drejt rezultateve konkrete dhe qëndrueshmërisë sistemike. Faza e ardhshme e procesit të anëtarësimit, e reflektuar tashmë në raportin e vitit 2025 dhe që pritet të theksohet edhe në vlerësimet e ardhshme, do të kërkojë nga Shqipëria të dëshmojë se institucionet e saj jo vetëm funksionojnë në mënyrë formale, por edhe prodhojnë rezultate të qëndrueshme në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian në praktikë.

6.2. Maqedonia e Veriut: Kornizë adekuate, progres i moderuar

Në kuadër të Grup Kapitujve 1 – Parimet Themelore, Maqedonia e Veriut vazhdon të vlerësohet nga Komisioni Evropian si mesatarisht e përgatitur, me njëfarë progresi të kufizuar dhe të paqëndrueshëm gjatë viteve të fundit. Korniza ligjore dhe institucionale është relativisht e konsoliduar, por sfida kryesore mbetet zbatimi efektiv i reformave dhe prodhimi i rezultateve konkrete, veçanërisht në sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit.

Historikisht, Maqedonia e Veriut ka qenë një nga vendet më të avancuara në rajon në procesin e integritit evropian, shpesh e konsideruar si “front runner”. Megjithatë, progresi i saj është ndikuar ndjeshëm nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Fillimisht, procesi u bllokua për vite të tëra për shkak të kontestit me Greqinë për çështjen e emrit, ndërsa së fundmi është penguar nga kushtëzimet e Bullgarisë, të lidhura me çështje historike dhe identitare. Këto

dinamika kanë krijuar një situatë ku progresi teknik nuk përkthehet në avancim real në procesin e integritit.

Në aspektin e brendshëm, vendi vazhdon të përballët me polarizim të theksuar politik, që ndikon në funksionimin e institucioneve demokratike dhe në miratimin e reformave kyçe, përfshirë ndryshimet kushtetuese. Po ashtu, dinamika ndëretnike dhe nevoja për balancim politik ndërmjet grupeve etnike mbeten faktorë të rëndësishëm në stabilitetin institucional dhe procesin vendimmarrës.

Në tërësi, Maqedonia e Veriut mbetet një vend me bazë të mirë ligjore dhe përgatitje relative, por i karakterizuar nga stagnim në avancimin e integritit për shkak të ndërthurjes së faktorëve politikë të brendshëm dhe kushtëzimeve të jashtme, duke e vendosur në një pozicion ndërmjet potencialit për progres dhe realitetit të ngecjes.

6.3. Kosova: Sfida e funksionimit institucional

Në kuadër të Grup Kapituljeve 1 – Parimet Themelore, Kosova vazhdon të vlerësohet nga Komisioni Evropian në fazë të hershme / me nivel të caktuar përgatitjeje, me progres të kufizuar dhe të paqëndrueshëm gjatë viteve të fundit. Ndryshe nga vendet e tjera të rajonit, sfida kryesore nuk lidhet vetëm me avancimin në procesin e integritit, por me funksionimin bazë të institucioneve dhe zbatimin e reformave në praktikë.

Në aspektin e sundimit të ligjit, megjithëse janë ndërmarrë iniciativa ligjore, progresi shpesh ka mbetur në nivel formal, ndërsa në praktikë është vërejtur mungesë konsistence, ndërhyrje politike dhe mungesë bashkëpunimi ndër-institucional. Boshllëqet institucionale, si funksionimi i dobët i organeve kyçe të drejtësisë dhe mungesa e rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, vazhdojnë të minojnë besueshmërinë e sistemit.

Në fushën e administratës publike, proceset reformuese janë karakterizuar nga paqartësi ligjore, vonesa dhe ndërhyrje të përsëritura kushtetuese, duke reflektuar një reformë të fragmentuar dhe pa drejtim të qartë. Në vend që të sigurojnë stabilitet dhe profesionalizëm, disa ndërhyrje kanë krijuar pasiguri juridike dhe institucionale.

Sa i përket funksionimit të institucioneve demokratike, sfidat lidhen me mungesën e koordinimit institucional, tensionet ndërmjet pushteteve dhe një qasje shpesh ad-hoc në vendimmarrje, që cenon parimet e ndarjes së pushteteve dhe llogaridhënies. Në këtë kontekst, viti 2025 mund të konsiderohet si një vit i humbur për ndërmarrjen e reformave të nevojshme në kuadër të Grup Kapituljeve 1, si pasojë e bllokadave institucionale dhe mungesës së funksionimit efektiv të institucioneve, çka ka penguar avancimin në fushat kyçe të sundimit të ligjit, administratës publike dhe qeverisjes demokratike.

Bazuar në raportet për vendin të Komisioni Evropian për tri vitet e fundit, progresi i Kosovës në procesin e integritit evropian mbetet i lidhur ngushtë me zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga dialogu me Serbinë i lehtësuar nga

Bashkimi Evropian. Raportet theksojnë në mënyrë të përsëritur se angazhimi konstruktiv dhe zbatimi i marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut janë kushte thelbësore për avancimin në rrugën drejt BE-së. Megjithëse Kosova ka treguar gatishmëri për të marrë pjesë në proces, progresi në zbatim mbetet i kufizuar dhe i paqëndrueshëm, shpesh i ndikuar nga zhvillimet politike dhe tensionet në terren. Bashkimi Evropian ka nënvizuar se moszbatimi apo zvarritja e obligimeve nga dialogu ndikon drejtpërdrejt në ritmin e integritit evropian, duke e bërë këtë proces jo vetëm çështje të politikës së jashtme, por një komponent të drejtpërdrejtë të reformave në kuadër të Grup Kapituujve 1. Si rrjedhojë, përparimi i Kosovës drejt Bashkimit Evropian mbetet i kushtëzuar jo vetëm nga reformat e brendshme, por edhe nga normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë dhe zbatimi efektiv i marrëveshjeve të dakorduara.

Një nga sfidat kyçe për Kosovën lidhet me faktin se, për shkak të nivelit më të ulët të avancimit në procesin e integritit dhe mosnjohjes nga pesë shtete anëtare të BE-së, vendi ka qasje të kufizuar në agjencitë e specializuara të Bashkimit Evropian. Këto agjenci përbëjnë platforma të rëndësishme për shkëmbimin e informacionit, përvojave dhe praktikave më të mira në zbatimin e reformave, veçanërisht në kuadër të Grupkapituujve 1 – Parimet Themelore. Si rrjedhojë, mungesa e pjesëmarrjes në këto mekanizma kufizon mundësitë për ngritje të kapaciteteve institucionale dhe përvetësim të standardeve evropiane në praktikë, duke e vështirësuar më tej zbatimin efektiv të kriterëve të integritit evropian.

Në tërësi, Kosova paraqet një rast ku ekziston një orientim i qartë strategjik drejt integritit evropian, por ky orientim nuk përkthehet në performancë institucionale të qëndrueshme dhe as në zbatim efektiv të obligimeve të marra. Përtej reformave të brendshme, progresi mbetet i kushtëzuar nga implementimi i detyrimeve që rrjedhin nga dialogu me Serbinë, të cilat vazhdojnë të karakterizohen nga një qasje selektive, jo gjithmonë konstruktive dhe shpesh e paqëndrueshme. Për më tepër, bllokadat institucionale, përplasjet politike dhe përdorimi i shpeshtë i mekanizmave kushtetues kanë prodhuar një paralizë funksionale që ka ngadalësuar ritmin e reformave. Kjo se bashku me mos zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga dialogu ka kontribuar në një perceptim gjithnjë e më skeptik nga Bashkimi Evropian mbi kapacitetin e Kosovës për të përmbushur obligimet e saj.

Si rrjedhojë, Kosova mbetet në një fazë të ndërtimit të kapaciteteve me stagnim në zbatim, ku problemi nuk qëndron vetëm në mungesën e reformave në letër, por në mungesën e vullnetit politik, koordinimit institucional dhe rezultateve konkrete në praktikë.

6.4. Kapitulli 23: Krahassimi mes vendeve të rajonit

Në kuadër të Kapitullit 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), raportet e Komisioni Evropian për vitet e fundit tregojnë dallime të qarta ndërmjet vendeve të rajonit, por edhe sfida të përbashkëta që lidhen me zbatimin dhe pavarësinë institucionale.

Shqipëria paraqitet si vendi me progresin më të avancuar, kryesisht falë reformës së thellë në drejtësi. Procesi i vetting-ut dhe funksionalizimi i institucioneve të reja kanë përmirësuar integritetin e sistemit gjyqësor. Megjithatë, sfida mbetet konsolidimi i rezultateve dhe krijimi i një “track record” të qëndrueshëm, sidomos në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.

Maqedonia e Veriut mbetet mesatarisht e përgatitur, por me progres të kufizuar dhe të paqëndrueshëm. Korniza ligjore është në vend, por sistemi gjyqësor vazhdon të përballlet me ndikime politike, mungesë efikasiteti dhe rezultate të kufizuara në luftën kundër korrupsionit, duke reflektuar një hendek të vazhdueshëm ndërmjet ligjit dhe praktikës.

Kosova ndodhet në një fazë më të hershme, me progres të kufizuar në këtë kapitull. Problemet kryesore lidhen me mungesën e pavarësisë së plotë institucionale, boshllëqet në funksionimin e organeve të drejtësisë dhe mungesën e rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit. Për më tepër, sfidat në koordinimin institucional dhe ndërhyrjet politike ndikojnë negativisht në performancën e sistemit.

Në mënyrë krahasimore, të tri vendet ndajnë një sfidë të përbashkët të mungesës e rezultateve të qëndrueshme dhe të matshme në sundimin e ligjit, pavarësisht ekzistencës së kornizave ligjore.

Në përfundim, Kapitulli 23 mbetet testi më kritik për avancimin në procesin e integritetit, ku dallimi ndërmjet vendeve qëndron kryesisht në nivelin e zbatimit dhe rezultateve konkrete, jo në miratimin e legjislacionit.

6.5. Kapitulli 24: Krahasimi mes vendeve të rajonit

Në kuadër të Kapitullit 24 (Drejtësia, liria dhe siguria), raportet e Komisioni Evropian tregojnë se vendet e rajonit kanë arritur një nivel të caktuar përgatitjeje, por progresi mbetet i pabarabartë dhe kryesisht i kufizuar, veçanërisht në zbatim dhe koordinim institucional.

Shqipëria paraqet progresin më të avancuar në këtë kapitull, me zhvillime të dukshme në bashkëpunimin ndërkombëtar policor, menaxhimin e kufijve dhe luftën kundër krimit të organizuar. Megjithatë, sfida mbetet konsolidimi i rezultateve dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve hetimore dhe ndjekjes penale, veçanërisht në rastet komplekse.

Maqedonia e Veriut mbetet mesatarisht e përgatitur, me njëfarë progresi në disa fusha si menaxhimi i migracionit dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, por me sfida të vazhdueshme në efikasitetin e zbatimit dhe koordinimin ndërmjet institucioneve të sigurisë. Progresi shpesh karakterizohet si i paqëndrueshëm dhe i ndikuar nga faktorë politikë dhe administrativë.

Kosova ndodhet në një nivel më të hershëm, me progres të kufizuar në shumicën e fushave të Kapitullit 24. Përkundër disa përmirësimeve në menaxhimin e kufijve dhe bashkëpunimin rajonal, sfidat mbeten në kapacitetet institucionale, koordinimin ndërinstitucional dhe luftën kundër krimit të organizuar. Mungesa e rezultateve konkrete dhe zbatimi i dobët i strategjive vazhdojnë të kufizojnë avancimin.

Në mënyrë krahasimore, të tri vendet përballen me sfida të ngjashme për nevojën për forcimin e kapaciteteve operacionale dhe sigurimin e rezultateve konkrete në luftën kundër krimit dhe menaxhimin e sigurisë.

Në përfundim, Kapitulli 24 tregon se, përkundër progresit në ndërtimin e kornizës dhe bashkëpunimit, avancimi real varet nga zbatimi efektiv, koordinimi institucional dhe rezultatet e prekshme në terren, duke mbetur një fushë kyçe për besueshmërinë e reformave në rajon.

7. Roli i Shoqërisë Civile

Raportet e Komisioni Evropian për Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut theksojnë se shoqëria civile mbetet një aktor kyç në avancimin e reformave, veçanërisht në kuadër të Grup Kapitujve 1 – Parimet Themelore, duke kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Në të tri vendet, ekziston një kornizë ligjore formale për konsultim publik, por raportet nënvizojnë se zbatimi shpesh mbetet i kufizuar. Shoqëria civile përfshihet në proceset e konsultimit, por shpesh në mënyrë formale dhe jo substanciale, me ndikim të kufizuar në politikat përfundimtare. Sfidat të përbashkëta përfshijnë qasjen e kufizuar në informacion, transparencën e pamjaftueshme dhe mungesën e një dialogu të strukturuar dhe të vazhdueshëm me institucionet.

Në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, shoqëria civile ka një rol më të konsoliduar në monitorimin e reformave dhe proceseve të integritetit, ndërsa në Kosovë, pavarësisht një sektori aktiv dhe kritik, ndikimi shpesh mbetet i kufizuar për shkak të mungesës së reagimit institucional dhe sfidave në implementim.

Megjithatë, në të gjitha vendet, shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm si “watchdog”, duke monitoruar performancën e institucioneve dhe duke kontribuar në identifikimin e mangësive në zbatimin e reformave. Ky rol është veçanërisht i rëndësishëm në fushat e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe reformës në administratën publike.

Në perspektivë, raportet sugjerojnë se roli i shoqërisë civile duhet të kalojë nga një përfshirje formale drejt një pjesëmarrjeje më substanciale dhe të institucionalizuar, duke forcuar mekanizmat e konsultimit dhe duke siguruar që kontributet e saj të reflektohen në vendimmarrje. Kjo kërkon një angazhim më të madh nga institucionet për të ndërtuar një partneritet funksional dhe të besueshëm me shoqërinë civile.

Kështu, si përfundim shoqëria civile mbetet një element thelbësor për funksionimin demokratik dhe avancimin e reformave, por potenciali i saj ende nuk është shfrytëzuar plotësisht. Forcimi i rolit të saj kërkon kalimin nga konsultimi formal në bashkëpunim real dhe ndikim të drejtpërdrejtë në politika.

8. Rekomandimet

Bazuar në gjetjet nga raportet e progresit, analizën rajonale dhe diskutimet e zhvilluara në kuadër të projektit, rekomandimet në vijim synojnë të adresojnë sfidat kyçe në kuadër të Grup Kapituave 1 – Parimet Themelore, me fokus në zbatimin efektiv të reformave dhe forcimin e institucioneve.

➤ **Kalimi nga reforma formale në rezultate konkrete (*track record*)**

Vendet e rajonit duhet të fokusohen në ndërtimin e një historiku të qëndrueshëm të rezultateve, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe funksionimin e gjyqësorit. Miratimi i legjislacionit nuk është më i mjaftueshëm; prioritet duhet të jetë zbatimi i tij dhe prodhimi i rezultateve të matshme dhe të verifikueshme.

➤ **Forcimi i pavarësisë dhe funksionimit të institucioneve të drejtësisë**

Është e domosdoshme të reduktohet ndërhyrja politike në sistemin gjyqësor dhe të sigurohet funksionimi i plotë i institucioneve kyçe. Kjo përfshin plotësimin e pozitive të lira, garantimin e mandatit të pavarur dhe rritjen e kapaciteteve profesionale.

➤ **Depolitizimi dhe profesionalizimi i administratës publike**

Reformat në administratën publike duhet të synojnë krijimin e një administrate profesionale, të qëndrueshme dhe të depolitizuar, e aftë për të zbatuar reformat dhe për të përmbushur obligimet që rrjedhin nga procesi i integritetit.

➤ **Forcimi i funksionimit të institucioneve demokratike**

Duhet të promovohet një kulturë e dialogut politik dhe bashkëpunimit ndërinstitutional, duke reduktuar polarizimin dhe duke rritur rolin mbikëqyrës të parlamenteve. Funksionimi efektiv i institucioneve është parakusht për avancimin në të gjitha fushat e tjera.

➤ **Rritja e kapaciteteve për zbatim dhe koordinim institucional**

Institucionet duhet të përmirësojnë koordinimin ndërmjet tyre dhe të forcojnë kapacitetet administrative për zbatim të politikave. Mungesa e koordinimit mbetet një nga pengesat kryesore për progres real në rajon.

➤ **Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile**

Duhet të sigurohet një përfshirje më substanciale e shoqërisë civile në vendimmarrje, duke kaluar nga konsultimi formal në partneritet real. Institucionet duhet të krijojnë mekanizma që garantojnë reflektimin e inputeve të shoqërisë civile në politika.

➤ **Rritja e parashikueshmërisë dhe besueshmërisë së procesit të integritetit nga BE**

Bashkimi Evropian duhet të sigurojë një proces më të parashikueshëm dhe të bazuar në meritë, duke minimizuar ndikimin e faktorëve politikë dhe çështjeve bilaterale që tejkalojnë performancën reale të vendeve.

➤ **Adresimi i ndikimit të faktorëve politikë dhe gjeopolitikë në procesin e integritetit**

Vendet dhe Bashkimi Evropian duhet të punojnë drejt një qasjeje që balancon dimensionin teknik dhe atë politik të integritetit, duke siguruar që procesi të mbetet i drejtë dhe motivues për vendet aspiruese.

